



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
REKTORATI

Nr. 130 / 1 Prot.

Vlorë, më, 13.12.2021

VENDIM

Nr. 34, datë 13. 12. 2021

PËR

**MIRATIMI I DRAFT RAPORTIT VJETOR TË VEPRIMTARISË SË UNIVERSITETIT
"ISMAIL QEMALI" VLORE, PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021.**

Bazuar në pikën g të Nenit 38 të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në pikën i të Nenit 19 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë si dhe në Udhëzimin Nr.5, datë 19. 02. 2018, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e elementeve përbërës të raportimit vjetor", Rektorati në mbledhjen e zhvilluar në datën 13. 12. 2021

VENDOSI

1. Miratimin e Draft Raportit Vjetor të veprimtarisë së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, për vitin akademik 2020-2021, hartuar mbi dokumentacionin e dorëzuar nga Fakultetet, Rektorati dhe Bordi i Administrimit, konform Udhëzimit Nr. 5, datë 19. 02. 2018 "Për përcaktimin e elementeve përbërës të Raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë".
2. Draft Raporti t'i përcillet Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit për shqyrtim dhe procedim të mëtejshëm.
3. Bashkëngjitur Draft Raporti Vjetor i veprimtarisë së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë për vitin akademik 2020-2021.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

REKTORI

Prof. Dr. Roland ZISI

